

MBI STATISTIKAT E  
BUJQËSISË DHE USHQIMIT

**Seri Allushi**  
**Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit**

## MBI STATISTIKAT E BUJQËSISË DHE USHQIMIT

Shqipëria, tani dhe për disa dekada të tjera, do të jetë një vend ku bujqësia do të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë kombëtare, në përgjithësi. Kontributi i saj në produktin e përgjithshëm kombëtar i kalon 50 për qind. Gati 2/3 e popullsisë jeton në fshat dhe merret me bujqësi, duke siguruar pjesën më të madhe të nevojave ushqimore. Nga ana tjetër, nga bujqësia varet në një shkallë të madhe, bilanci i eksport-importit të vendit, si për të siguruar valutën, ashtu edhe për ta kursyer atë duke ulur importin e produkteve ushqimore.

Duke qenë se bujqësia ka këtë pozicion të rëndësishëm në panoramën ekonomike të vendit, inkurajimi i saj përbën një nga prioritetet e reformës ekonomike, që po zbatohet nga Qeveria. Në këtë aspekt, nevoja për një informacion statistikor të saktë e të besueshëm është një domosdoshmëri, si për njohjen e gjendjes, ashtu dhe për analizën e saj dhe përcaktimin e politikave prioritare të zhvillimit të bujqësisë.

Me shpërbërjen e kooperativave dhe të ndërmarrjeve bujqësore kanë ndodhur ndryshime të mëdha e thelbësore në bujqësinë shqiptare. Në vend të 600 kooperativave dhe të 110 ndërmarrjeve shtetërore, që ishin më parë, sot ushtrojnë aktivitetin e tyre rreth 450.000 fermerë privatë të bujqësisë. Ky ndryshim i sistemit ekonomik në bujqësi, nga një ekonomi tejet e centralizuar në një ekonomi të privatizuar, nxori krejtësisht të pavlefshme, kriteret metodologjike të zbatuara më parë për grumbullimin e informacionit statistikor.

Përpara këtij problemi të rëndësishëm u krye riorganizimi dhe ristrukturimi i të gjithë shërbimit statistikor të sistemit të bujqësisë dhe ushqimit, në përputhje me kushtet e reja, të krijuara pas privatizimit masiv të bujqësisë, duke vënë si objektiv futjen e metodave bashkëkohore për të siguruar një informacion statistikor të saktë e të besueshëm. Për realizimin e këtij objekti lindi nevoja për një mbështetje më të mirë të shërbimit statistikor, si nga ana teknike dhe nga ajo financiare.

Kjo mbështetje u mundësua nëpërmjet programeve të financuara nga Agjencia për Zhvillimin Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID) mbështetje, e cila vazhdon ende. Objektivi i këtyre programeve ka qenë dhe vazhdon të jetë vendosja dhe institucionalizimi i sistemeve të informacionit bujqësor bashkëkohor, që drejtohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit e Shqipërisë.

Për këtë qëllim, me mbështetjen e USAID-it, nëpërmjet projektit SARA (Support for Agricultural Restructuring in Albania) me pjesëmarrjen e ekspertëve amerikanë dhe të drejtorisë së statistikës në MBU u krye studimi dhe u përcaktua, si metoda më e përshtatshme për mbledhjen e informacionit statistikor në bujqësi, "**Metoda e sipërfaqes së kufizuar Moster**" ose siç quhet ndryshe ASF. Kjo metodë përbën strategjinë e duhur për vendosjen e sistemit të informacionit statistikor në baza teknike bashkëkohore të ngjashme me ato, që përdoren edhe në vendet perëndimore dhe në SHBA.

Ekzistojnë shumë metoda për mbledhjen e informacionit statistikor, por, për kushtet e Shqipërisë u konsiderua si më efikase metoda e sipërfaqes së kufizuar Moster, mbasi ka këto përparësi:

- mundësitë e përdorimit të saj për kryerjen e vëzhgimeve të ndryshme janë të pakufizuara;
- niveli i saktësisë së të dhënave është i matshëm;
- reduktohen në masë më të madhe gabimet jo të mostrës;
- mostra ASF mund të përdoret për një kohë mjaft të gjatë.
- Kjo metodë merr përparësi veçanërisht në kushtet e vendit tonë ku lëvizja e vendbanimit të fermerëve është e vazhdueshme dhe nuk mund të aplikohet metoda e listimit të fermerëve.

Aplikimi i kësaj metode u realizua nëpërmjet një mbështetjeje teknike e financiare nga SHBA, si dhe një angazhimi serioz, si nga ana e stafit të Drejtorisë së Statistikës ashtu edhe nga ana e eksperteve amerikanë të projektit SARA. Implementimi i kësaj metode kaloi në disa faza të rëndësishme si ndërtimi i mostrës, identifikimi i segmenteve të zgjedhura në terren, listimi i fermerëve në segment dhe zgjedhja e tyre, hartimi i pyetësorit dhe testimi i tij, mbledhja e të dhënave nëpërmjet intervistave, hedhja dhe përpunimi i tyre në kompjuter, përpilimi dhe nxjerrja e tabelave përmbledhëse, deri në publikimin e tyre etj..

Për ndërtimin e mostrës u përcaktua si kriter bazë **“Intensiteti i kultivimit të tokës”**. Në bazë të këtyre kriterëve, me ndihmën e hartave topografike dhe të imazheve satelitore u shtresëzua gjithë territori i Republikës e, për çdo, prefekturë në 7 shtresa ose stratumë. Nga të cilat, mbas ndarjesh e nëndarjesh me ndihmën e sistemit gjeografik të informacionit (GIS) u arrit deri tek përcaktimi i rreth 3000 segmenteve të zgjedhura, të cilat u identifikuan konkretisht në terren.

Këto segmente, tashmë janë baza nga të cilat grumbullohet çdo lloj informacioni që nevojitet.

Mbas gjithë kësaj pune u arrit ndërtimi i mostrës dhe mund të themi se Shqipëria tanimë, ka një instrument të rëndësishëm e të besueshëm, që mund të përdoret për të nxjerrë vlerësime efikase e objektive me shkallë saktësie të matshme në fushën e bujqësisë, të blegtorisë, të pemëtarisë etj.. Ai, gjithashtu, është përdorur në studime social-ekonomike dhe të ambientit. Studimi i “Sipërfaqes së Kufizuar Mostër” është parashikuar të përdoret me efikasitet për të mbështetur vlerësimet social-ekonomike, strategjitë e marketingut dhe burimet pyjore, pra për sigurimin e një baze të dhënash, nëpërmjet të cilave mund të pasqyrohet informacioni i mjaftueshëm për tregues të ndryshëm sasiorë e cilësorë, të bujqësisë, të blegtorisë, të pemëtarisë etj.

Mbështetur në këtë mostër tashmë të ndërtuar qysh nga viti 1992 e deri më sot, janë realizuar një sërë vëzhgimesh në sektorët e bujqësisë, nëpërmjet të cilave sigurohen të dhëna statistikore në nivel Republike e prefekturë, që nga numri i fermave, numri i popullatës, përbërja familjare, mosha, gjinia, arsimi, punësimi etj., si dhe të dhëna të tjera, që lidhen me aktivitetin ekonomik të fermës si për strukturën e mbjelljeve, numrin e krerëve, numrin e rrënjëve të pemëtoreve, prodhimet e rendimentet në bimët e arave, blegtori e pemëtari. Inputet e përdorura, shitjet, çmimet, kostot, të ardhurat, gjendja e mekanikës bujqësore dhe volumi i punimeve që realizon e një mori të dhënash të tjera, të cilat kanë shërbyer për të planifikuar tendencat e zhvillimit të degëve të ndryshme të bujqësisë, por edhe për të analizuar në përcaktimin e problemeve prioritare më eficiente në vendimmarrje për zhvillimin e degëve të bujqësisë.

Tani mund të thuhet se metoda e “Sipërfaqes së kufizuar Mostër”, e cila ofron mundësi të pakufizuara në përdorim, përbën metodën kryesore të grumbullimit të statistikave bujqësore në Shqipëri.

Ajo është përvetësuar dhe përdoret me sukses nga personeli i Shërbimit Statistikor të Ministrisë së Bujqësisë e Ushqimit. Gjithashtu, janë bërë programet e punës për të zgjeruar e përsosur akoma më tej këto metoda të statistikës probabile.

Duke filluar qysh nga viti 1994 e deri sot janë programuar vëzhgimet, që kryhen sistematikisht çdo vit, dhe, konkretisht, realizohen 2 vëzhgime tërësore të bujqësisë një në muajin qershor dhe një në dhjetor, ku përfshihen bimët e arave, pemëtaria e blegtoria, një vëzhgim për serat, një vëzhgim për fermat e mëdha etj..

Nëpërmjet këtyre vëzhgimeve ne sigurojmë të dhëna për treguesit kryesorë ekonomikë të bujqësisë në një nivel të pranueshëm besueshmërie, ku koeficienti i variacionit lëviz nga 3 në 10 për qind, në shkallë Republike. Megjithëkëtë, ne konstatojmë se është e nevojshme që të ristrukturohet e të përmirësohet më tej kjo mostër për këto arsye:

- disa nga të dhënat, që sigurojmë në nivel prefekturë janë ende me koeficient të lartë gabimi;
- për disa bimë bujqësore, që kanë shpërndarje të rajonizuar, siç janë ulliri, agrumet, vreshtat etj. mostra ekzistuese nuk funksionon normalisht e për këtë lind nevoja e ndërtimit të mostrave specifike;
- nuk sigurohen të dhëna në nivel rrethi, prandaj, në varësi të riorganizimit të ndarjes administrative e territoriale të Republikës, do të lindë edhe nevoja e rishikimit të mostrës etj..

Por, shërbimit të Statistikës dhe Informacionit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit i dalin detyra për të zgjidhur edhe ne fushën e statistikave të sektorit të industrisë ushqimore, që lidhen me sigurimin e të dhënave për numrin e bizneseve, llojet e aktiviteteve përpunuese, kapacitetet, prodhimin, përpunimin, investimet, pagat, shpenzimet, të ardhurat etj.. si dhe në fushën e sigurimit të informacionit për çmimet e tregut të shitjes me pakicë.

Edhe për zgjidhjen e këtij problemi, me mbështetjen financiare dhe teknike nga USAD-i, u organizua puna dhe u ndërtuan programet e posaçme informative me metodën e listimit të bizneseve. Ne kemi vite që kryejmë vëzhgime për agropërpunimin çdo tremujor, ndërsa për çmimet e tregut të shitjes me pakicë kryejmë vëzhgime çdo muaj e çdo javë.

Të dhënat, që grumbullohen nga këto vëzhgime në bujqësi, agroindustri, çmime etj. përbëjnë një bazë të mirë për sigurimin e të dhënave të nevojshme për të fiksuar treguesit ekonomikë të zhvillimit të bujqësisë. Mbështetur në këto të dhëna, çdo vit, nga ana jonë, botohet Vjetari Statistikor për sistemin e bujqësisë dhe ushqimit.

Së fundi, desha të theksoj se grumbullimi i informacionit statistikor në bujqësi është një proces, që kërkon kombinimin dhe përdorimin e një sërë metodash dhe se ai nuk mund të realizohet me një metodë të vetme, sado e përdorur të jetë ajo. Nga ky kombinim do të varet shumë saktësia dhe besueshmëria e të dhënave statistikore në fushën e bujqësisë. Është kjo arsye që ne kërkojmë një mbështetje më të madhe në të ardhmen edhe nga organizma të specializuara të Komunitetit Europian.

Por, megjithë punën e deritanishme për ristrukturimin dhe përmirësimin e statistikave të sistemit të bujqësisë mendojmë se si në këtë fushë edhe për ristrukturimin e gjithë sistemit statistikor, në përgjithësi, ka ende mjaft punë për të bërë e probleme për të zgjidhur.

Së pari, ligji nr. 7687, datë 16.03.1993 "Për statistikën", duhet domosdoshmërisht, të përmirësohet në disa drejtime, duke ndarë qartë kompetencat, detyrat dhe detyrimet ndërmjet ISTAT-it, dikastereve dhe institucioneve të tjera qendrore. Të përcaktohen qartë detyrimet e subjekteve për të dhënë informacion statistikor dhe të fuqizohen sanksionet e kompetencat e organeve të statistikës.

Së dyti, është domosdoshmëri bashkëpunimi reciprok midis INSTAT-it dhe dikastereve e institucioneve të tjera qendrore. Nga eksperiencia e deritanishme, duke bashkëpunuar MBU me INSTAT-in për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore, u arrit të realizohej një aktivitet mjaft i rëndësishëm. Ne, si dikaster, po bëjmë përpjekje për të rritur nivelin e bashkëpunimit në fushën e vrojtimeve të bujqësisë e deri tek publikimi i të dhënave të ndryshme statistikore.

Së treti, është e nevojshme që shërbimi i statistikës të mbështetet më shumë vemendje si nga Qeveria, ashtu dhe nga donatorët. Me rëndësi dhe emergjent është përmirësimi i bazës materiale e teknike, mbasi nuk mund të realizohet informacioni me pajisje tepër të vjetëruara.

Së katërti, të krijohen mundësi e hapësira për trainimin e specialistëve të statistikës, si dhe për pjesëmarrjen e tyre në veprimtari europiane e ndërkombëtare. Nuk mund të konsiderohet normale që në veprimtaritë, që organizohen nga organizma europiane e ndërkombëtare si EUROSTAT e FAO, për statistikën e bujqësisë dhe të ushqimit të mos ftohet e sponsorizohet shërbimi i statistikave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Së fundi, për mbarëvajtjen e punës mund të konsiderohet nevojë e kohës rishikimi edhe i nivelit të INSTAT-it, duke patur parasysh edhe eksperiencën ndërkombëtare, mbasi është institucion mjaft i rëndësishëm.

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit ka marrë përsipër gjithë përgjegjësinë për krijimin e një sistemi statistikor bashkëkohor dhe ju siguron se do të jeni gjithmonë të mirëpritur për të bashkëpunuar në fushën e statistikave bujqësore.